

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-25-10289-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me material medicinal për Ortopedi nga Lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së – LOT 1.**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ **OE “ORTHO - IMPLANTS SH.P.K.”** _____

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ **Rr. Kadri Harapi 6** _____

(Adresa)

_____ **Pejë** _____

(Vendi)

_____ **30000** _____

(Kodi postar)

_____ **+383 49526491** _____

(Numri Telefonit)

_____ _____

(Numri i Faks-it)

_____ **Hikmet Ukaj** _____

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **orthoimplants2011@gmail.com** _____

(Adresa elektronike)

_____ **22.06.2026** _____

(Data e parashtrimit të ankesës)

_____ _____

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim me material medicinal për Ortopedi nga Lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së;**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 12.11.2025 ndërsa hapja publike është bërë në datën 08.05.2026.

AK me datë 30.04.2026 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së andaj të pakënaqur me këtë vendim, po i drejtohem AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 11.06.2026 ka publikuar vendimin e shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të cilën e ka refuzuar, andaj të pakënaqur me këtë refuzim po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderëve është bërë në datën 08.05.2026. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 12.11.2025 ndërsa hapja publike është bërë në datën 08.05.2026.

AK me datë 30.04.2026 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së andaj të pakënaqur me këtë vendim, po i drejtohem AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datën 11.06.2026 ka publikuar vendimin e shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të cilën e ka refuzuar, andaj të pakënaqur me këtë refuzim po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 19 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit, nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe **ekonomike**. Kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Thirrja kinse në ofertën tonë si të papërgjegjshme për mangësi të pabazuara edhe pse çmimi i ofertuar nga ne është më i ulët se sa ofertat konkurrense, tregon se AK po e përdor vetëm si arsyetim fiktiv këtë arsye për tentim të eliminimit të tenderit tonë. AK me këtë veprim po tenton ta vë në lajthitje opinionin, duke i keq interpretuar kinse disa mangësi të tenderit tonë dhe në të njëjtën kohë ka anashkaluar shumë mangësi më të ndjeshme tek GEO i shpallur fitues. Pra AK ka lëshuar shumë mangësi tek tenderuesi i shpallur fitues që janë shumë më të mëdha se sa kjo që ka aplikuar tek ne dhe me këtë shihet se qëllimisht po tenton të na dëmtoj neve dhe buxhetin e vet AK-së. E themi këtë sepse tenderi jonë posedon çmimi më të ulët për **553,238.40€**. Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe marrë për bazë mënyrën se si ishin përshkruar kërkesat e dosjes së tenderit, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së duke mos vlerësuar tenderin tonë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe duke mos administruar procedurën e prokurimit sipas neneve të cekura më lartë.

Kjo tregon hapur se gjatë vlerësimit të tenderëve, AK ka shkelur plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK e ka konsideruar të përgjegjshëm GOE të shpallur fitues edhe pse ka shumë mangësi në tenderin e tijë ndërsa neve nga eliminuar edhe pse mangësitë tona të potencuara nga AK janë minore në krahasim me ato të fituesit. Nga arsyetimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me tenderin e GOE të shpallur fitues, shihet se gjendja në tenderin e GOE të shpallur fitues është e pa pranueshme. Këtu po shihet qartë se AK ka aplikuar standarde të dyfishta pasi që nuk po e zbaton nenin 59 të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit në mënyrë të barabartë për të gjithë tenderuesit.

Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së dhe krejt çka shihet tek vlerësimi i AK-së, konsiderohet shkelje ligjore, trajtim jo i barabartë i tenderuesve dhe favorizim i GOE që e ka shpallur fitues. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit ashtu siç e parashihet neni në fjalë duke mos bërë vlerësim, sqarim dhe krahasim të drejtë të tenderuesve.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

E themi këtë sepse shihet se AK e ka pranuar si të rregullt tenderin e GOE që e ka shpallur fitues edhe pse i njëjti posedon shumë mangësi të theksuara dhe shumë domethënëse në tenderin e tijë ndërsa neve na ka eliminuar me arsye time të pabazuar për të cilat ka mundur edhe të kërkojë sqarime por që nuk e ka marrur fare mundimin ta bëjë. Krejt kjo ka ndikuar negativisht në shpenzimin jo ekonomik të parasë publike pasi që ka shpërblyer si fitues një tenderues që posedon çmimin **553,238.40€** më të lartë se ne.

Arsyeja e eliminimit të tenderit tonë për Lot 1 duket kështu:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM

AK-SHSKUK në dosjen e tenderit në pikë 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar:

Kërkesa 6. Operatori Ekonomik ofertues se bashku me ofertë, duhet që të sjellë nga një mostër te produktit.

Evidenca 6. Operatori Ekonomik ofertues se bashku me ofertë, duhet që të sjellë nga një mostër te produktit (një mostër për lloj të produktit për Lot) mostra duhet te jete origjinale e prodhuesit dhe duhet te përmbajë shenjë identifikuese te prodhuesit. Mostrat dorëzohen para datës së hapjes së ofertave 08.05.2026 ora 13:00,

Ju si OE ofertues nuk ka dorëzuar mostrat për pozicionet e shënuara me poshtë:

-Në pikën 2.1, ACETABULUM

nënpikën 2.1.1,

nënpika 2.1.2,

nënpika 2.1.3,

nënpika 2.1.4,

nënpika 2.1.5, dhe

nënpika 2.1.6 mungojnë Mostrat ashtu siç janë kërkuar në kërkesë nr.6 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 të Dosjes se tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Është kërkuar mostër për produktin: pika 2.3 HEAD DIAMETER 28 and 32, për diametrin 32 mungon Mostra.

Është kërkuar mostër për produktin: pikën 2.3.3 CERAMIC HEAD DIAMETER 28 - 3 SIZES dhe pikën 2.3.4 CERAMIC HEAD DIAMETER 32- 3 SIZES mungon Mostra.

Është kërkuar mostër për produktin: pikën 3.1.7 STANDARD LINERS (INSERTS) FOR 22,28 and 32 FOR PRESS-FIT mungon mostra për diametrin 32.

Është kërkuar mostër për produktin: pikën 3.3 HEAD DIAMETER 22,28,32 mungon mostra për 22 dhe 32.

Është kërkuar mostër për produktin: pikën 3.3.4 CERAMIC HEAD DIAMETER 28 - 3 SIZES dhe pika 3.3.5 CERAMIC HEAD DIAMETER 32- 3 SIZES mungojnë mostrat.

Është kërkuar mostër për produktin: ASYMMETRICAL AND ANATOMIC FEMUR AND TIBIAL FOR RIGHT AND LEFT KNEE , për këtë pozicion mungon mostra e kërkuar.

Është kërkuar mostër për produktin: MIN.8 SIZES AND 5 THICKNESSES OF TIBIAL LINERS (9 TO 18 MM OR EQUIVALENT) FOR CRUCIATE RETAINING për këtë pozicion mungon mostra e kërkuar.

Është kërkuar seti në pikën 7.1 SET FOR APPLICATION OF CEMENTED KNEE PROSTHESES për këtë pozicion mungon seti i kërkuar.

Po ashtu:

AK-SHSKUK në dosjen e tenderit në pikë 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar:

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te përcjellur me referenca apo raporte te pranimit 1.3 here ne vlere te parashikuar te Lotit për Lotët që oferton.

Evidenca 5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te përcjellur me referenca apo raporte te pranimit 1.3 here ne vlere te parashikuar te Lotit për Lotët që oferton.

Në këtë rast për Lot 1 janë kërkuar që OE ofertues duhet të ketë kontrata të kryera në vlerë prej 7,108,193.11 euro, ju si OE ofertues për Lot 1 ka ofruar dëshmi vetëm 781,486.92 euro e cila vlerë nuk e përmbushë kërkesën 5 të nenit 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Tani në vazhdim po paraqesim pretendimet tona kundër arsyetimeve të pabazuara të eliminimit tonë si dhe pretendimet tona për mangësitë në tenderin fitues, e që AK i ka anashkalluar pa i trajtuar fare:

3.1.1 Pretendimi lidhur me arsyetimin e parë të eliminimit tonë është i pabazuar dhe përveç kësaj është edhe tendencioz pasi që pozicioni 2 në listë ka qenë me disa numra të madhësive të tyre por të gjitha nën produktet e tilla janë të njëjta vetëm se ndryshojnë për nga madhësia. Me vet faktin që çmimi është kërkuar si total i pozicionit 2 dhe me vet faktin që nën artikujt e tillë janë kërkuar njëjtë por vetëm ndryshojnë për nga numri i madhësisë, mbështetur çdo herë edhe në kërkesën e përshkruar tek FDT-ja për mostrat, del që ne e kemi plotësuar kriterin e tillë pasi që e kemi dorëzuar mostrën e produktit të quajtur POLYETHYLENE ACETABULUM UHMWPE. Kërkesa nuk ka qenë që të dorëzohen të gjithë numrat e madhësive andaj kriteri i tillë konsiderohet i pranueshëm. I njëjti arsyetim vlen edhe për mostrat e pikës 3 pasi që edhe mostrat e tilla ne i kemi dorëzuar saktë ashtu siç ishte kërkesa e dosës së tenderit. AK ka mundur edhe të kërkoj sqarime shtesë pasi që një gjë të tillë ia lejon nenin 59.4 dhe 72 i LPP-së.

3.1.2 Pretendimi lidhur me mangësinë e parë tek GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”. Nëse veç do duhej aplikuar kriterin e tillë për mungesë mostrash në secilin numër të madhësisë së artikullit në fjalë, atëherë AK gjatë vlerësimit ka aplikuar standardin e dyfishtë sepse as GOE “LAYO SH.P.K. & Layo” i shpallur si fitues nuk ka dorëzuar mostra për produktin në nën pikën 2.1.3, 2.1.4, 2.1.5 dhe 2.1.6.. Po që se do zbatohet kërkesa e tillë si e barabartë për të gjithë tenderuesit atëherë edhe tenderuesi që AK e ka shpallur fitues do duhej konsideruar i papërgjegjshëm. Nga kjo shihet se AK përpos që ka shkelur nenin 59 të LPP-së, këtu ka shkelur edhe nenin 7 të LPP-së sepse ka bërë trajtim të pabarabartë të tenderuesve përkatësisht ka bërë favorizim të fituesit dhe diskriminim të tenderit tonë.

3.2.1 Pretendimi lidhur me arsyetimin e dytë të eliminimit tonë gjithashtu është i pabazuar pasi që kërkesa e dosjes së tenderit tek pika 5 e specifikimit teknik ka qenë e përcaktuar si mundësi e ofertimit të njërit prej artikujve të cekur. Për më saktë ne po e paraqesim se si dukej saktë kërkesa e tillë:

5	TOTAL KNEE PROsthESIS, CEMENTED, PRIMARY	Or equivalent
	BICONDYLAR TYPE OF PROsthESIS	Or equivalent
	ALL COMPONENTS OF PROsthESIS CEMENTED	Or equivalent
	ASYMMETRICAL AND ANATOMIC FEMUR AND TIBIAL FOR RIGHT AND LEFT KNEE	Or equivalent
	CRUCIATE RETAINING OR SACRIFICING PCL SURGICAL TECHNIQUE	Or equivalent
	MINIMUM 8 SIZES OF FEMORAL COMPONENTS	Or equivalent

Bazuar në kërkesën e tillë po shihet qartë se vet AK e ka lënë si mundësi që të ofertohet me njërin lloj të produktit pasi që vet e ka konstatuar duke potencuar “CRUCIATE RETAINING OR SACRIFICING PCL SURGICAL TECHNIQUE”. Pra përdorimi i lidhëse OR(ose) tregon që ne nuk kemi qenë të detyruar të ofertojmë me të dy modelet. Nisur nga kjo ne kemi dorëzuar edhe mostrën përkatëse e cila i përgjigjet ofertës së ofruar. Realisht po që se do ofertonim me të dy modelet, do të shkelej automatikisht pika 4.1 e FDT-së pasi që aty nuk lejohen variantet.

3.2.2 Pretendimi lidhur me mangësinë e dytë tek GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”. Vlen të ceket se GOE i shpallu fitues ka aplikuar me të dy modelet e që realisht do duhej cilësuar i papërgjegjshëm pasi që ofertimi me variante ka qenë i ndaluar. Na si duket kërkesa e FDT-së:

Varijante	4.1	Variante autorizohen: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
-----------	-----	--

Mundësia e dhënë për ofertim me njërin apo tjetrin model, nuk nënkupton që mundesh të ofertosh me dy modelet sepse pika katër e FDT-së e ka ndaluar një veprim të tillë andaj në rastin konkret, realisht ne jemi tenderues i përgjegjshëm ndërsa GOE i shpallur fitues është tenderues i papërgjegjshëm. Veprimi i tillë i AK-së përpos që konsiderohet shkelje e nenit 59 të LPP-së, konsiderohet edhe trajtim i pa barabartë i tenderuesve që bie në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së.

3.3.1 Pretendimi lidhur me arsyetimin e tretë të eliminimit tonë është i pabazuar dhe duket kështu:

Është kërkuar mostër për produktin: ASYMMETRICAL AND ANATOMIC FEMUR AND TIBIAL FOR RIGHT AND LEFT KNEE , për këtë pozicion mungon mostra e kërkuar.
Është kërkuar mostër për produktin: MIN.8 SIZES AND 5 THICKNESSES OF TIBIAL LINERS (9 TO 18 MM OR EQUIVALENT) FOR CRUCIATE RETAINING për këtë pozicion mungon mostra e kërkuar.

Kjo nuk qëndron fare sepse ne e kemi dorëzuar mostrën saktë ashtu siç ishte kërkesa pasi që vet kërkesa e linte si mundësi dorëzimin apo ofertimin e njërit model apo tjetrit. Kjo është e cekur edhe vizualisht më sipër dhe i përgjigjet plotësisht arsyetimit të tillë. Dmth. me që ne kemi ofertuar me llojin e gjurit që quhet KNEO PS (posterior stabilisation) që posedon 11 madhësi të majta dhe të djathta, është normale dhe plotësisht e pranueshme që edhe mostra të dorëzohet vetëm për llojin e asaj që kemi ofertuar. Po që se do dorëzoheshin dy modelet, atëherë do e shkëlqim pikën 4.1 të FDT-ës nga ku shihet se ofertimi me variante ka qenë i ndaluar.

3.3.2 Pretendimi lidhur me mangësinë e tretë tek GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”. AK këtu përpos që ka vlersuar gabimisht tenderin tonë, ka bërë edhe favorizim të GOE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti nuk e ka ofertuar këtë artikull ashtu siç ishte kërkesa e specifikimit teknik dhe se për këtë është dashur të cilësohej i papërgjegjshëm. Kërkesa e

specifikimit teknik i pikës 5 ka qenë që ky produkt duhet të posedoj së paku 8 madhësi të sajë. Ja si dukej Kërkesa në fjalë:

5	TOTAL KNEE PROSTHESIS, CEMENTED, PRIMARY	Or equivalent
	BICONDYLAR TYPE OF PROSTHESIS	Or equivalent
	ALL COMPONENTS OF PROSTHESIS CEMENTED	Or equivalent
	ASYMMETRICAL AND ANATOMIC FEMUR AND TIBIAL FOR RIGHT AND LEFT KNEE	Or equivalent
	CRUCIATE RETAINING OR SACRIFICING PCL SURGICAL TECHNIQUE	Or equivalent
	MINIMUM 8 SIZES OF FEMORAL COMPONENTS	Or equivalent

GOE “LAYO SH.P.K. & Layo” në ofertën e tijë përpos që ka ofertuar me dy modele e që realisht bëhet tenderues i papërgjegjshëm, nuk ka arritur të ofertoj produktin që posedon numrat e kërkuar nga AK. Në këtë kërkesë janë përcaktuar se produkti në fjalë duhet posedoj së paku 8 madhësi të numrave të djathtë ose të majtë, ndërsa ky GOE ka ofertuar me një produkt që posedon vetëm 6 numra të madhësive femorale. Mos plotësimi i specifikimit teknik, sipas nenit 19.11 të RRPP-001/2022 i cili qartë e përcakton se:

19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.

Pra me që ky GOE nuk i posedon numrat e madhësive të kërkuara, realisht konsiderohet tenderues i papërgjegjshëm. Për të ju bindur më saktë me këtë që theksuam më lartë. Ja si duken numrat e ofertuar nga ky tenderues:

ANTHEM^o Femoral implants			
ANTHEM PS Femorals (CoCr)			
Narrow			
Cat. No.	Description	Cat. No.	Description
71422801	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 1 Left N	71422821	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 1 Right N
71422802	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 2 Left N	71422822	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 2 Right N
71422803	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 3 Left N	71422823	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 3 Right N
71422804	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 4 Left N	71422824	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 4 Right N
71422805	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 5 Left N	71422825	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 5 Right N
71422806	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 6 Left N	71422826	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 6 Right N
Standard			
Cat. No.	Description	Cat. No.	Description
71422813	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 3 Left	71422833	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 3 Right
71422814	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 4 Left	71422834	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 4 Right
71422815	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 5 Left	71422835	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 5 Right
71422816	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 6 Left	71422836	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 6 Right
71422817	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 7 Left	71422837	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 7 Right
71422818	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 8 Left	71422838	ANTHEM Femoral PS CoCr Size 8 Right

Pra nga kjo po shihet se përpos që ka ofertuar me modelin NARROW dhe STANDARD me të cilët ka shkelur nenin 4,1 të FDT-së, shihet se për secilin model ka ofruar përkatësisht posedon vetëm nga 6 madhësi femorale. Mos plotësimi i këtij kriteri i përcaktuar tek specifikimi teknik, këtë tenderues e bënë plotësisht të papërgjegjshëm ndërsa AK-në e bënë shkelëse të plotë të nenit 59 të LPP-së dhe 19 të RRPP-001/2022.

3.4.1 Pretendimi lidhur me arsyetimin e katërt të eliminimit tonë është i pabazuar me vet faktin që ne kemi deklaruar se i plotësojmë të gjitha specifikimet e kërkuara saktë si në dosjen e tenderit, nënkupton se ky set vjen së bashku me impiantet e gjurit me të cilat edhe kemi ofertuar. Edhe pse tek arsyetimi për eliminim AK e pozicionin këtë artikull tek pika 7.1, realisht në dosjen e tenderit dhe listën e çmimeve ai ndodhet tek pika 6 dhe titullohet SET FOR APPLICATION OF CEMENTED KNEE PROSTHESES.

3.4.2 Pretendimi lidhur me mangësinë e katërt tek GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”. Edhe këtu AK ka aplikuar standarde të dyfishta pasi që as GOE i shpallur fitues nuk e ka ofertuar setin e tillë (*shihë listën e çmimeve te tije*) dhe se eliminimi i tenderit tonë përbën diskriminim të plotë dhe shkelje flagrante të nenit 7 dhe 59 të LPP-së.

3.5.1 Pretendimi lidhur me arsyetimin e pestë të eliminimit tonë është gjithashtu i pabazuar sepse realisht AK është dashur të na kërkoj sqarime pasi që bazuar në LPP, AK ka të drejtë të kërkoj sqarime lidhur me projekte e realizuara në tre vite e fundit. Mos aplikimi i kërkesës për sqarim, tregon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.4 dhe 72 të LPP-së.

3.5.2 Pretendimi lidhur me mangësinë e pestë tek GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”. Edhe këtu AK ka aplikuar standard të dyfishtë pasi që nuk ka kërkuar fare sqarim nga GEO i shpallur fitues për referencat që ky tenderues i ka paraqitur me blerës privat. Bazuar në rregulloren e prokurimit çdo here kur tenderuesi dorëzon projekte të realizuara me blerës privat, AK duhet të i kërkoj transaksionet bankare për tu siguruar se referencat e tilla janë reale dhe nuk janë fiktive. Pra mos kërkesa e transaksioneve nga ana e AK-së për mbulimin e referencave me blerës privat, përpos që konsiderohet favorizim ndaj këtij GOE, del të jetë në kundërshtim RRPP-001/2022 lidhur me verifikimin e transaksioneve të paraqitura me blerës privat. Pra pa referencat e paraqitura me blerës privat, tenderuesi në fjalë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për vlerën e projekteve të realizuara andaj edhe do duhej cilësuar i papërgjegjshëm

Nga krejt kjo që theksuam më sipër, shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së kur na ka eliminuar neve nga konkurrenca si dhe nuk ka respektuar si duhet nenin 59 të LPP-së dhe as kërkesat e veta edhe kur e ka e shpallur si fitues tenderuesin **GOE “LAYO SH.P.K. & Layo”**, pasi që tenderi i tij posedon mangësi shumë të theksuara që e bëjnë plotësisht të papërgjegjshëm. Mangësitë e tyre i kemi renditur çdo here pas kontestimit të arsyetimeve për eliminim që AK na i ka atribuar neve.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vlerësuar drejt sipas kriterit të paraqitur në dosje të tenderit. Me që ne shihet se jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi edhe çmimin më të ulët në krahasim me konkurrencën, i bie se AK përpos që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar as kriterin e vlerësimit që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Krejt kjo ka ardhur si pasoj e asaj kur AK e ka konsideruar të përgjegjshëm GOE të shpallur fitues edhe pse i njëjti ka mangësi në tenderin e tij ndërsa neve pa asnjë të drejtë na ka eliminuar nga konkurrenca e mëtutjeshme. Mos respektimi i neneve tjera siç është neni 7 dhe 59 i LPP-së e shtynë AK-në drejt shkelje së plotë të nenit 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta sipas nenit 69 të LPP-së. AK ka vendosur vet kërkesa teknike (specifikime teknike) që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që gjatë vlerësimit nuk i ka zbatuar si duhet. Kërkesat për përshtatshmërinë profesionale që janë kërkuar nga AK shihet se ky i fundit i ka keq aplikuar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit tonë ndërsa i ka anashkaluar plotësisht kur e ka vlerësuar tenderin e GOE që më pas pa asnjë të drejtë ligjore e ka shpallur fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek kërkesat e FDT-së dhe tek specifikim teknik, kemi të bëjmë edhe me favorizim të një OE të papërgjegjshëm.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime tek ne për paqartësitë që shihet se i ka pasur, ndërsa edhe përkundër gabimeve që i kishte GOE i shpallur fitues, atë e cilëson padrejtësisht të përgjegjshëm . Këtu shihet qartë mos aplikimi i drejtë nenit 72 ku për neve nuk e merr fare mundimin të na kërkoj sqarime shtesë ndërsa GOE që e ka shpallur fitues shihet se ia ka pranuar shumicën e dëshmimeve edhe pse ishin si të parregullta dhe të mangëta. Veprimet e tilla përpos që konsiderohen shkelje e nenit 7 të LPP-së, konsiderohen aplikim selektiv i mundësisë dhe shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së.

7. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së pasi që gjatë shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim nuk i ka trajtuar si duhet pretendimet tona madje pretendimet që i kemi parashtruar për mangësitë në tenderit e Grupit të OE që ishte shpallur fitues, AK nuk i ka shqyrtuar fare. AK gjatë përgjigjes në pretendimet tona nuk ka ofruar asnjë argument apo fakt shtesë për të na i refuzuar pretendimet tona lidhur me arsyetimet e pabazuara të eliminimit tonë. Pra ky veprim i AK-së shihet qartë se bie ndesh me nenin 108/A.12 pasi që arsyetimi për refuzim nuk është aspak i argumentuar e për më keq nuk është as i faktuar. Veprimin e një në shkelje të plotë të paragrafit 12 të këtij neni, AK e ka bërë edhe kur nuk i ka trajtuar fare pretendimet tona lidhur me mangësitë në tenderin e Grupit të OE të shpallur si fitues. Nga krejt kjo që u tha, po shihet se edhe këtu AK ka aplikuar standard të dyfishtë të aplikimit të nenit 108/A të LPP-së andaj s'kemi se të mendojmë ndryshe përveç që AK ka shkelur plotësisht nenin 108/A të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar Ankesa e OE “**ORTHO - IMPLANTS SH.P.K.**” lidhur me tenderin “**Furnizim me material medicinal për Ortopedi nga Lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së**” – **LOT 1** i iniciuar nga **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim** ose nëse AK këmbëngul në mangësitë e tenderit tonë e që të njëjtat i posedon edhe GEO i shpallur fitues, atëherë të **ANULOJ** tenderin në tërësi.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit e sidomos ato të specifikimit teknik, që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE “**ORTHO - IMPLANTS SH.P.K.**”.












9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme përfshi ato në fushën financiare, fitime të munguara dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (4)
-  3 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (5)
-  4 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (6)
-  5 Dosja e Tenderit (Shqip)
-  6 Përshkrimi i çmimit - LOT 1
-  7 PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT
-  8 Raporti i vleresimit te tenderve
-  9 Njoftim mbi Vendimin e AK
-  10 KERKESE PER RISHQYRTIM - SHSKUK - ORTHO IMPLANTS SHPK 10.06.2026
-  11 Vendim mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim-Ortho Implants

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*